



Pranuar / Dorezuar Received / Delivery	15.06.2022	viti year	2
Organ / Njësia Organ / Jednica Org./Unit	SKRPHJK	Numri i Protokollit / Prot. No.	3511/2022
Shtesa / Prilog / Appendix		Sasia / Kolicina Quantity	1/5



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.465/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani-kryetar, Malsore Gashi- Bajraktari dhe Jeton Koca-anëtarë, me Rushit Kajtazi -Zyrtar i lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr. 465/2022 të datës 18.05.2022 të parashtruar nga ankuesi [redacted] me adresë banimi: [redacted] nga [redacted] kundër organit të punësimit/Shërbimit Korrektues të Kosovës, në çështjen juridike "Masë Disiplinore", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 15.06.2022, mori këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet si e bazuar ankesa me numër A.nr.465/2022, e datës 18.05.2022 e parashtruar nga ankuesi [redacted]
- II. Anulohet Vendimi KD.Nr.020-/2022 i datës 15.04.2022 i Komisionit Disiplinor të Shërbimit Korrektues të Kosovës dhe lënda kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje të organi i njëjtë.
- III. Obligohet Komisioni Disiplinor në Shërbimin Korrektues të Kosovës, që brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi, të ndërmarr të gjitha veprimet ligjore për zbatimin e këtij vendimit ashtu siç është përcaktuar në pikën II të dispozitivit.
- IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Ankuesi [REDACTED] me datë 18.05.2022, me numër protokoli 2894/2022, ka parashtruar ankesën në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet ankimore, kundër vendimit të datës 15.04.2022, të Komisionit Disiplinor, të Shërbimit Korrektues të Kosovës, lidhur me masën disiplinore „ ndalim 20% ,e pagës për periudhën një muaj”.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 25.05.2022 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesën e ankuesit tek Shërbimi Korrektues të Kosovës. Ndërsa Këshilli me datë 02.06.2022,ka pranua nga Shërbimi Korrektues të Kosovës përgjigjen në kërkesë me numër protokoli:3217/2022, se bashku me shkresat e bashkangjitura.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka administruar këto prova: Ankesën A. Nr. 465/2022 të datës 18.05.2022 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimi KD. Nr. 020-2022, i datës 15.04.2022, i Komisionit Disiplinor; Vendimi i datës 20.01.2016; Thirrje për intervistë; Inicimi i procedurës disiplinore; Vendimi i datës 12.01.2016; Propozim për mase disiplinore; Vendimi i datës 12.01.2016; Proceverrabi i intervistimit i ditës 13.01.2016; Raport i datës 12.12.2015; Deklaratë e datës 12.12.2015; lista e vijueshmërisë për ndërrim e natës; Vendimi me numër protokoli 1204, i datës 26.10.2021; Vendimi i datës 15.03.2022; Raporti përfundimtar i hetimeve, lidhur me zbardhjen e rastit të vizitës së lirë, nga i burgosuri F.M, i datës 07.02.2022; Vendimi i datës 31.01.2022; Aktgjykimi A. P.S, i Gjykatës Themelore në Prishtinë/Departamenti Special; Aktgjykimi APS, Nr. 1/21, i Gjykatës së Apelit të Kosovës; Formuari për vlerësimin e beneficioneve; Kërkesë e datës 15.03.2021; Informate e përgjithshme e datës 19.03.2021; vizitë e lirë e datës 22.03.2021; Certifikatë e datës 16.03.2021; kërkesë për beneficione e datës 30.04.2021; rivlerësimin për beneficione; Kërkesë e datës 28.09.2021; Vendimi i datës 27.10.2020; Njoftim i datës 08.09.2021; Njoftim i datës 26.04.2021; Njoftim i datës 21.07.2021; Njoftim i datës 28.09.2021; Kontrata e punës e datës 06.09.2018; Inicimi i procedurës disiplinore i datës 16.06.2022; Procesverbali i datës 06.04.2022; Akt Emërimi i datës 05.03.2013; Diplomë e datës 14.07.2016; Akt Emërimi i datës 21.10.2014; Diplomë e datës 15.03.2017; Diplomë e datës 27.06.2014; Kontrata e punës e datës 15.07.2020; Vendimi i datës 01.10.2021; Vendimi i datës 18.02.2022; Diplomë e datës 29.06.2013; Diplomë e datës 22.01.2016; Përgjigje në ankesë e datës 02.06.2022, me numër protokoli 3217/2022, me shkresat e bashkangjitura.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas shqyrtimit dhe analizimit të shkresave të lëndës të parashtruara nga palët, konstatoi se janë përmbushur kushtet ligjore që lënda të kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje të organi i njëjtë, *sepse*:

Nga administrimi i provave materiale, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka gjetur që ankuesi është i punësuar në pozitën Udhëheqës për Siguri në Burgun e Sigurisë së Lartë.

Bazuar në Raportin e Komisionit Hetimor me numër protokoll 0115 të datës 07.02.2022, kryesuesi i Komisionit Disiplinor me datë 10.03.2022 ka parashtruar kërkesë për inicim të procedurës disiplinore ndaj ankuesit me pretendimin se sipas të gjeturave nga Raporti Hetimor ankuesi ka bërë shkelje të rënda të detyrës së punës pasi që i njëjti ka vepruar në kundërshtim me nenin 48 paragrafi 2 të Udhëzimit Administrativ MD nr.07/2015 për Rendin Shtëpiak në Institucionet Korrektues.

Komisioni Disiplinor i Shërbimit Korrektues të Kosovës me Vendimin KD.nr.020-/2022 të datës 15.04.2022, ka konstatuar së ankuesi në cilësinë e anëtarit të Panelit për Benificione ka aprovuar tri kërkesa të të dënuarit F.M për befinicione (qëndrim në lokale të veçanta me bashkëshorten) në kundërshtim me dispozita e Udhëzimit Administrativ MD nr.07/2015 për Rendin Shtëpiak në Institucionet Korrektues, duke e shpall përgjegjës për shkelje të rëndë disiplinore nga neni 46 paragrafi 3 nën paragrafi 3.3 dhe 3.10 lidhur me nenin 28 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë si dhe nenin 48 paragrafi 1 pika 1.1 dhe paragrafi 2 të Udhëzimit Administrativ MD Nr.07/2015 për Rendin Shtëpiak në Institucionet Korrektues, dhe ndaj të njëjtit ka shqiptuar masën disiplinore "ndalimi 20% i pagës për periudhën prej një muaj" sipas nenit 47 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë.

Ankuesi kundër Vendimit KD.Nr.020-/2022 të datës 15.04.2022 të Komisionit Disiplinor të Shërbimit Korrektues të Kosovës, brenda afatit ligjor ushtron ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimin ankimore që anëtari i Komisioni Disiplinor [redacted] ka konflikt interesin në këtë çështje për faktin që në kohën kur kam ushtruar këtë pozitë kam bërë inicimin e procedurës disiplinore ndaj tij, ndërsa të njëjtit i është shqiptuar pastaj masë disiplinore.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka analizuar respektimin e dispozitave thelbësore procedurale lidhur me këtë çështja administrative dhe rrjedhimisht nga analizimi i provave materiale ka konstatuar së Zëvendësuesi i Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit me Vendimin më numër protokoll 1187 të datës 20.10.2021 ka themeluar Komisionin Disiplinor me mandat tre vjeçar, ndërsa me datë 11.02.2022 pra tri ditë pas Raportit Hetimor të datës 07.02.2022, ka ndryshuar në tërësi përbërjen e anëtarëve të këtij komisioni duke themeluar Komision të ri Disiplinor sipas Vendimit me numër protokoll 0139 të datës 11.02.2022, pa dhënë ndonjë arsyetim se për cilat shkaqe bëhet ndryshimi i përbërjes së Komisionit Disiplinor, kështu që një veprim i tillë gjegjësisht ndryshimi i përbërjes së Komisionit Disiplinor sipas rasteve, krijon pasiguri juridike për nëpunësit civil në kuadër të Shërbimit Korrektues dhe si i tillë është në kundërshtim me parimin e ligjshmërisë të përcaktuar me nenin 4 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative me të cilin parashihet se: *1. Organet publike veprojnë në përputhje me Kushtetutën, legjislacionin në fuqi, si edhe me rregullat e përgjithshme administrative të zbatueshme brenda kompetencave të tyre dhe në përputhje me qëllimin për të cilat janë dhënë këto kompetenca. 2. Veprimi administrativ*

që cenon apo mund të cenojë një të drejtë apo interes juridik të një personi, duhet të jetë i autorizuar nga një ligj....

Po ashtu, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka konstatuar së anëtari i Komisionit Disiplinor [redacted] nuk ka deklaruar konfliktin e interesit në procedurën disiplinore ndaj ankuesit, siç përshihet me dispozitat e nenit 29 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 dhe 1.10 të Ligji Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative si dhe nenin 10 paragrafin 5 nën paragrafin 5.2 të Rregullores (QRK) Nr.11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë. Nga administrimi i shkresave të lëndës, Kolegji konstaton se përmes ankuesit [redacted] më datë 23.12.2015 është iniciuar procedura disiplinore ndaj Sadat Murturi, ndërsa si rezultat i këtij iniciimi Komisioni Disiplinor për Drejtorinë e Burgut të Sigurisë së Lart me Vendimin e datës 12.01.2016 kishte propozuar që ndaj [redacted] të shqiptohet masa disiplinore "qortim me vërejtje me shkrim", Andaj, Kolegji vlerëson së nxjerrja e vendimit të goditur me ankesë, mbi bazën e ekzistimit të këtyre rrethanave të konfliktit të interesit është në kundërshtim të plotë me dispozitat e nenit 29 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 dhe 1.10 të Ligji Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative si dhe nenin 10 paragrafin 5 nën paragrafin 5.2 të Rregullores (QRK) Nr.11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë.

Mbi këtë gjendje të fakteve, Kolegji vlerëson së Vendimi KD.Nr.020-/2022 i datës 15.04.2022 i Komisionit Disiplinor të Shërbimit Korrektues të Kosovës është i përfshirë më të meta të atilla që pengojnë vendosjen në mënyrë meritore lidhur me këtë çështja, kështu që organi i punësimit gjegjësisht Komisioni Disiplinor në riprocedurë duhet të eliminoj shkeljet e konstatuar sipas këtij vendimi, dhe të nxjerr vendim në pajtim me legjislacionin në fuqi dhe në mbështetje të fakteve të vërtetuara në mënyrë të plotë dhe drejtë.

Nisur si me lartë, Kolegji pas shqyrtimit të shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 dhe 1.6 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Iniciimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.465/2022

Rushit KAJTAZI

Procesmbajtës

Eshref SHABANI

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues të Kosovës;
- Komisionit Disiplinor të Shërbimit Korrektues të Kosovës;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Shërbimin Korrektues të Kosovës dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së

